

E nderuar kryetare e Kuvendit, zonja Nikolla,

I nderuar minister, zoti Çuçi,

Të nderuarat zonja Bushka e zonja Lakomy,

Dhuna mbi bazë gjinore vijon të mbetet në fokusin e veprimtarisë institucionale të prokurorisë, jo vetëm si një nga objektivat që vendosen çdo vit në kuadër të luftës ndaj krimit. Ne e konsiderojmë këtë fenomen si një sfidë me rëndësi thelbësore që kërkon një qëndrim më strategjik, në funksion të realizimit të një impakti të thellë e afatgjatë për shoqërinë. Kjo qasje na ka nxitur ta shndërrojmë këtë tryezë në një traditë të përvitshme, si një nevojë për të diskutuar dhe koordinuar masat institucionale në nivel legjislativ e penal edhe përmes përfshirjes së shoqërisë civile, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit shoqëror drejt reagimit dhe raportimit të mënjehershëm të çdo forme të dhunës dhe orientimin e duhur të viktimave drejt strukturave kompetente.

Prokuroria e Përgjithshme mbetet konsistente në vlerësimin e saj se masat që duhen marrë në përgjigje të këtij fenomeni duhet të përfshijnë disa aktorë, si dhe të jenë të shoqëruara nga analiza të thelluara shumëplanëshe, me natyrë kriminologjike e më gjerë, periodike dhe transparente për publikun. Gjenerimi dhe përdorimi efikas i tërësisë së energjisë shoqërore që sjell ndryshime të vërteta, të prekshme, larg slloganeve e publicitetit shterpë, mbeten sfida dhe detyra jonë e përbashkët.

Është për t'u vlerësuar fakti që ndjeshmëria shoqërore dhe institucionale ndaj dhunës mbi bazë gjinore ka ardhur në rritje dhe kjo ka çuar në një përmirësim të efikasitetit të institucioneve ligjzbatuese në këtë fushë. Edhe vetë kompozimi i kësaj tryeze është provë e seriozitetit të një angazhimi tashmë gjithëpërfshirës, me potencialin e krijimit të sinergjive me fuqi transformuese.

Në se do t'i hidhnim një vështrim krahasues të dhënave statistikore për 9-mujorin e vitit 2021, vihet re një trend rritës i veprës penale të dhunës në familje në krahasim me një vit më parë me 977 procedime penale të regjistruara në krahasim me 932 në vitin 2020. Shqetësues mbetet fakti se një prirje me kah në rritje haset edhe në kryerjen e veprës penale në mënyrë të përsëritur dhe në prani të fëmijëve.

Një rritje më e lehtë vihet re tek "Krimet seksuale", ku shifrat krahasimore për 9-mujorin shfaqin një numër më të lartë të procedimeve për këto krime, 116 të tilla nga 106 të një viti më parë.

Nuk ka ndryshime situata për veprat penale kundër fëmijëve, martesës, familjes, ku numri i procedimeve penale të regjistruara për të njëjtën periudhë krahasimore është në nivelin e 62 procedimeve. Megjithatë, dua të nxjerr në pah këtu një të dhënë shqetësuese që pasqyron një shtim të rasteve të veprës penale të "Keqtrajtimit të të miturve". Ngjarjet e rënda të ndodhura këtë vit me viktima të miturit, janë tregues të një problemi serioz në shoqëri, që bën të domosdoshëm një vëmendje të shtuar institucionale e më gjerë. Dhuna ndaj të miturve, për shkak të pamundësisë dhe paaftësisë së viktimave për të perceptuar e raportuar krimet, e bën mjaft të ndërlikuar e të vështirë ndërmarrjen e masave efikase, duke marrë në konsideratë

edhe faktorët social, ekonomik e kulturor që ndikojnë jo pak në trajtimin e duhur të fenomenit. Të miturit janë pjesa më vulnerabël e shoqërisë dhe ata kanë nevojë më shumë se kushdo për praninë dhe mbrojtjen tonë. Për më tepër keqtrajtimi i të miturve përgjithësisht ndodh në një ambient ku dhuna ndaj gruas është prezente dhe e përsëritur. Dhunimi i tyre apo rritja e tyre në ambiente ku dhuna është pjesë e përditshmërisë dëmton të ardhmen e vendit në mënyrë të pariparueshme, pasi përbën parathënien e shoqërisë së nesërme ku dhuna mund të pranohet në pikëpamje kulturore si normalitet e të dhunuarit e sotëm potencialisht mund të shndërrohen në dhunuesit e ardhshëm. Ndaj mbetet thelbësor një angazhim serioz i prokurorëve, si në vlerësimin e kujdesshëm të çdo të dhëne e më tej hetimin e plotë të fakteve, ashtu edhe në qëndrimin e ashpër për sa i përket masave të dënimit për autorët. Toleranca apo indiferenca institucionale në rastet e dhunës kundrejt të gjithë personave vulnerabël ndaj saj, brenda familjes apo në ambiente të tjera sociale, frymëzojnë akte të tjera dhune.

Një moment tjetër ku dua të ndalem është mungesa e të dhënave të besueshme statistikore dhe analitike për ndikimin e pandemisë në nivelin e dhunës mbi baza gjinore. Në nivel global ka një vëmendje të shtuar për të analizuar se si vendosja e kufizimeve të lëvizjeve, zhvillimi online i mësimin dhe aktiviteteve profesionale, që ka rritur kohën e qëndrimit në banesë të personave të çdo kategorie sociale ka ndikuar në rritjen e raportimeve të dhunës së familje, veçanërisht në rastet e episodeve të përsëritura, të njohura nga autoritetet lokale. Mungesa e raportimeve për shkak të kufizimeve të ndryshme që janë aplikuar për të kufizuar pandeminë mund të jetë një faktor shpjegues për mospërputhjen e prirjeve në aspektin statistikor në vendin tonë.

Të dhënat në rang botëror tregojnë për një rritje të dhunës përmes përdorimit të rrjeteve kompjuterike, veçanërisht gjatë pandemisë, për shkak të përdorimit të shtuar të platformave

virtuale, të cilat e lehtësojnë ndjeshëm kontaktin mes autorëve dhe viktimave potenciale. Nga ana jonë duhet të synohet përfshirja e dhunës kibernetike ndaj grave dhe vajzave në të dhëna statistikore të veçanta, për të vlerësuar më mirë përmasat e problemit dhe masat që mund të merren.

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të Prokurorisë së Përgjithshme sa i takon rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe në zbatim të rekomandimeve të grupit të Ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (grevio) dhe Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (Ecri) nga ana jonë janë marrë disa masa si :

- Miratimi i udhëzimit mbi hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës me bazë urrejtje, që adreson detyrimet e konventës së Stambollit. Ky udhëzim synon të unifikojë masat procedurale në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm, nxitjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe organizatat e shoqërisë civile, në kryerjen e trajnimeve, hartimin e protokolleve dhe strategjive specifike në trajtimin e rasteve ku përfshihen viktimat të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe dhunës me bazë urrejtje.
- Masë tjetër është nxjerrja e udhëzimit mbi hetimin dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar.

Megjithë përpjekjet e kryera, sërish mbetet ende shumë për t'u bërë në këtë drejtim si p.sh. për sa i përket përmirësimit dhe mirëfunksionimit të sistemit statistikor në funksion të gjenerimit dhe analizimit të të dhënave, duke krijuar një sistem fleksibël bazuar në nevojat e organit të

prokurorisë, kuvendit apo institucioneve të tjera ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare me të cilat Prokuroria e Përgjithshme shkëmben informacione.

Duhet të vazhdojmë të fokusohemi tek rritja e profesionalizmit në trajtimin e rasteve që përfshijnë një subjekt me status të posaçëm, si të miturit apo gratë e vajzat viktimë e dhunës ose përdhunimit, për të parandaluar trajtimin diskriminues ndaj viktimës. Dua të nxis dhe inkurajoj këtu koordinatorët të sinjalizojnë çdo rast ku evidentohet apo ka dyshime për raste të tilla. Është thelbësore që viktima mos t'i nënshtrohet riviktimizimit nga autorët apo nga aktorët e tjerë shtetërorë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre ndërkohë që ende duhet punuar në drejtim të standartizimit të praktikave që sigurojnë mbrojtjen e të dhënave personale të viktimave.

Në një artikull të shtatorit 2021, revista The Economist, në një artikull me titullin “Kostoja e shtypjes së grave”, mbështetur në një punim me titullin “Rendi i parë politik: Si gjinia i jep formë qeverisjes dhe sigurisë kombëtare në rang botëror”, arrin në konkluzionin se vendet që trajtojnë keq femrat janë më të varfra dhe kanë më pak stabilitet. Në renditjen e 176 vendeve në një shkallë nga 0-16, që merr në konsideratë faktorë të tillë si trajtimin e pabarabartë të gruas në të drejtën familjare apo të drejtën e pronës, martesën e hershme për vajzat, jetesën pas martesës në familjen e burrit, poligaminë, çmimin e nuses, preferencat për lindjen e djemve, dhunën ndaj grave dhe qëndrimet e shoqërisë ndaj kësaj dhune, demokracitë e pasura qartazi dalin të parat. Australia, Suedia dhe Zvicra kanë indeksin zero, ndërkohë që Iraku, Nigeria Jemeni apo Afganistani kanë tregues shifrën 15. Konkluzioni i tre autoreve të punimit është se: “Duket se mënyra më e mirë për të mallkuar një komb është t'i nënvlerësosh e ulësh gratë e tij në një rang inferior”. Këto të dhëna nxjerrin disa përfundime ku dua të veçoj dy më kryesoret:

Së pari, ka një rëndësi thelbësore të kuptohet se e ardhmja dhe progresi i vendit është në raport të drejtë me nivelin e garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të gruas si dhe rolin e saj në shoqëri.

Së dyti, nivelet e larta të dhunës me bazë gjinore mund të jenë tregues i problemeve më të thella shoqërore, që nuk mund të zgjidhen vetëm nga organet e drejtësisë, nëpërmjet parandalimit apo ndëshkimit të autorëve.

Çështja është shumë më komplekse dhe kërkon një strategji disaplanëshe. Është e domosdoshme një analizë e plotë dhe e thelluar e situatës aktuale, për të nxjerrë në pah shkaqet e vërteta të kësaj dhune, qofshin ato sociale, kulturore apo ekonomike. Kemi ndoshta nevojë për një revolucion të vërtetë shoqëror në drejtim të perceptimit të fenomeneve të dhunës dhe diskriminimit si pengesa serioze të progresit, që kërkojnë angazhimin konkret të çdo strukture shtetërore, të çdo organizmi jo qeveritar, të çdo entiteti apo grupi shoqëror.

Prokuroria mbetet tërësisht e angazhuar për të përmbushur rolin e saj në këtë drejtim, përpjekje kjo që ka nevojë të mbështetet në mënyrë koherente edhe në kuadrin e një qasje vizionare shumëplanëshe ndërinstitucionale e më gjerë.

Ju faleminderit!